

Nr. .... Prot

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/ 2024

Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

### FTESË PËR OFERTË

**"PËR SISTEMIN DINAMIK TË BILETAVE TË TRANSPORTIT AJROR NDËRKOMBËTAR".**

#### Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)  
Adresa Rruga "Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.  
Tel/Faks +355 42 228 349, +355 42 239 295  
E-mail [hasar@kesh.al](mailto:hasar@kesh.al)  
Ueb-faqe [www.kesh.al](http://www.kesh.al)

Autoriteti Kontraktor KESH sh.a, do të zhvillojë procedurën e prokurimit nëpërmjet sistemit dinamik të blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar, me objekt: **"Blerje 8 (tetë) bileta avioni"**, me destinacion Beogradin në datat 6 shkurt - 10 shkurt 2024.

**Data e zhvillimit do të jetë 05.02.2023 (jo më pak se 3 orë nga momenti i publikimit), ora 14:00 në adresën: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).**

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna:

#### Specifikimet teknike:

##### **Bileta Avioni, sasia 8 (tetë).**

Udhëtimi i përfaqësuesve të KESH sh.a që dërgohen me shërbim jashtë vendit do të realizohet me anë të transportit ajror, (avion), sipas detajeve më poshtë:

- ✚ Nisja do të realizohet me datë 06 Shkurt 2024, me avion, në itinerarin Tiranë-Beograd dhe mbërritja në destinacion brenda orës 24:00.
- ✚ Kthimi do të realizohet me datë 10 Shkurt 2024, me avion, në itinerarin Beograd – Tiranë, ;
- ✚ Fluturimi të jetë linjë direkte/jo më shumë se një tranzit;
- ✚ Klasi ekonomik (economy flex);
- ✚ Bagazhi i përfshirë, për secilin;

#### **Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, dokumentet si më poshtë:**

- 1) Rezervimin e biletës, sipas destinacionit të kërkuar;
- 2) Operatori Ekonomik duhet të ketë të parashikuar në objektin e veprimtarisë së tij fushën e objektit të prokurimit;
- 3) Një dokument që vërteton se subjekti juaj ka plotësuar detyrimet fiskale, lëshuar nga Administrata Tatimore;
- 4) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qëndrore të faturave;
- 5) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara deri në muajin e fundit të energjisë elektrike;

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Çdo kriter i mësipërm, i cili nuk plotësohet, përbën kusht për skualifikim.**

*Në rast anullimesh apo vonesash nga kompanitë ajrore të fluturimit, Operatori Ekonomik do të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktor për riorganizimin e itinerarit.*

OE duhet të garantojë përballimin e çdo pasojë të mundshme ekonomike, në raste të jashtëzakonshme, si fatkeqësi natyrore, kushte të këqija të motit, grevë apo falimentim të operatorit, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fluturimit, orarit të biletës dhe të ditës së fluturimit, të cilat nuk vijnë si pasojë e veprimit të Autoritetit Kontraktor.

Afati i dorëzimit të dokumenteve do të jetë jo me pak se 2 (dy) orë nga shpallja e njoftimit të fituesit. Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues në zyrën e protokollit të KESH sh.a. Në të kundërt, do të bëhet kalimi të ofertuesi i radhës i kualifikuar në SPE, e kështu me radhë, deri në ofertuesin e fundit të mbetur në klasifikim.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

**PËR TITULLARIN E AUTORITETIT KONTRAKTOR  
PERSONI I AUTORIZUAR**

**Joana BUSHI**